

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"Kedma Albania Group" SHPK**

Ortakët themelues të Shoqërisë :

1.Ardiola Bushati, me atësi Kujtim, e datëlindjes 28.05.1982, lindur në Skrapar dhe me banim në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me numër personal ID I25528089E.

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

mbledhur në Tiranë sot më datë 14.12.2018.

**VENDOSËN:**

Të krijojnë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

**Emri**

- 1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "Kedma Albania Group" SHPK  
1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

**NENI 2**

**Forma juridike**

- 2.1 Shoqëria tregtare "Kedma Albania Group" shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.  
2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

**NENI 3**

**Selia**

- 3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugën "Papa Gjon Pali II", Aba Business Center, 12, Tiranë.  
3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.  
3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra



përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

#### **NENI 4** **Vula e shoqërisë**

**4.1** Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**4.2** Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;

#### **NENI 5** **Objekti i Veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është: tregtimi i artikujve kozmetike dhe veprimtari të tjera në fushën e estetikës dhe rekreacionit, si edhe import-eksport të produkteve estetike, kozmetike dhe parfumerisë, shampo, aromatizues të llojeve të ndryshme, import-eksport, tregtim dhe shitje me shumicë dhe pakicë të një game të gjere produktesh shëndeti, kozmetike, bukurie, krem, locione, fragrance, parfume si dhe produkte të tjera dytesore të kësaj kategorie.

#### **NENI 6** **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

**6.1** Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

**6.2** Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **NENI 7** **Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat**

**7.1** Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100 (njqind) lekë.

- Ardiola Bushati, zotëron një kuotë me vlerën 100 (njqind) leke, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

**7.2** Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesëshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

**7.3** Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

#### **NENI 8** **Organet e Shoqërisë**

**8.1** Organet drejtuese të shoqërisë janë:



- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

#### **NENI 9 Administratori**

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

9.2 Administrator i Shoqërisë do të jete Ardiola Bushati.

#### **NENI 10 Dispozita të fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

#### **NENI 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.*

*Ortaku nënshkruan më dëshirë dhe vullnet të plotë aktin themelues të shoqërisë.*

#### **ORTAKET THEMELUES**

Ardiola Bushati

